



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 22.09.2016

Ref.:876/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Udhëzimin Administrativ 01/2013, datë 16.01.2013, neni 8, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

I. I rekomandohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ndryshimi i statusit juridik të BPrAL "QEAP Heimerer" nga Shkolla e Lartë Profesionale në Kolegj.

A r s y e t i m

BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale "Qeap Heimerer", me datë 16.10.2015 (465/15) ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për ndryshimin e statusit juridik nga Shkolla e Lartë Profesionale në Kolegj.

Pasi që institucioni i lartcekur ofron edhe program të studimit në nivelin Master, KSHC vendosi të aprovojë kërkesën e BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale "QEAP Heimerer", dhe ti rekomandojë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ndryshimin e statusit juridik nga Shkolla e Lartë Profesionale në Kolegj.

Bazuar në nenin 11, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, dhe nenin 8 të Udhëzimit Administrativ 01/2013, datë 16.01.2013, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale “Qeap Heimerer”
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë